



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

---

**STUDIM MBI PROBLEMATIKAT  
E DISKRIMINIMIT TË KOMUNITETIT ROM  
NË SHQIPËRI**



Dhjetor 2014



## Përmbajtja

<b>Në vend të parathënies</b> .....	5
<b>HYRJE</b> .....	6
<b>I. Krijimi i kuadrit ligjor të domosdoshëm që garanton të drejtat e komunitetit rom</b> .....	7
<b>II. Hartimi i politikave që synojnë reduktimin e dallimeve dhe nxitjen e zbatimit të parimit të barazisë</b> .....	9
II.1 Identifikimi i natyrës së çështjeve dhe pengesave.....	10
II.1.1. Ofrimi i shërbimeve në respekt të diversitetit dhe pa u diskriminuar.....	10
II.1.2. Arsimi.....	13
II.1.3. Punësimi.....	15
II.2. Përcaktimi i prioriteteve kryesore dhe promovimi i praktikave të mira.....	15
<b>III. Krijimi i kuadrit institucional për mbrojtjen e të drejtave të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri</b> .....	16
III.1. Identifikimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si mbrojtës i komunitetit në trajtimin e problematikave të komunitetit rom.....	17
III.1.1. Edukimi dhe legjislacioni anti-diskriminim përmes strategjive të informimit.....	18

III. 1.2. Kryerja e sondazheve dhe monitorimeve të pavarura në lidhje me diskriminimin.....	21
III.1.3. Publikimi i raporteve dhe dhënia e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.....	22
<b>IV. Bashkëpunimi me aktorët e tjerë.....</b>	<b>24</b>
<b>Konkluzione dhe Rekomandime.....</b>	<b>27</b>
<b>Literatura.....</b>	<b>28</b>

## **Në vend të parathënies**

Një numër i konsiderueshëm minoritetesh, përfshirë dhe romët, jetojnë në Shqipëri. Krijimi i legjislacionit dhe politikave mbi minoritetet është një ndër masat që vendi ynë ka projektuar të ndërmarrë në kuadër të pesë prioritetëve të vendosura nga Komisioni European ndaj Shqipërisë.

Shqipëria ka miratuar një legjislacion në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe ka krijuar mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi të komunitetit rom. Mbrojtja e minoriteteve garantohet nga Kushtetuta dhe ligjet, që parashikojnë respektimin e të drejtave të tyre. Shqipëria ka një kuadër të gjerë institucional për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit rom. Njohja e këtyre institucioneve ka një rëndësi thelbësore në realizimin e të drejtave të tyre.

Çdo institucion ka pjesën e vet të përgjegjësisë, por bashkëpunimi dhe koordinimi mes tyre është thelbësor për të siguruar rezultatet më të mira. Për implementimin e dokumenteve strategjike të miratuara në vendin tonë kërkohet bashkëpunim dhe koordinim mes qeverisjes qendrore dhe vendore.

Problematikat e strehimit, aksesit në gëzimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, promovimi i punësimit të romëve mbeten probleme kryesore.

Institucionet e barazisë ndeshen me tre sfida të rëndësishme gjatë trajtimit të rasteve të diskriminimit ndaj romëve: (i) masat pozitive, (ii) forcimin e OJF-ve në vendimmarrje, (iii) ofrimin e shërbimeve në respekt të diversitetit dhe duke promovuar barazinë.

Në këtë studim do të përpiqemi të pasqyrojmë nga këndvështrimi i institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi problematikat e këtij komuniteti, mbështetur në veprimtarinë e institucionit, por edhe me informacionet, sugjerimet dhe rekomandimet e bëra nga aktorë të tjerë të institucioneve qendrore e vendore, OJF dhe institucioneve të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

**Irma BARAKU**

**Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

**Dhjetor 2014**

## HYRJJE

Trajtimi i komunitetit rom si një pakicë brenda shoqërisë shqiptare ndesh që në fillim me një mungesë të përkufizimit juridik të minoritetit si në nivelin e akteve ndërkombëtare ashtu edhe në legjislacionin e brendshëm. Ka pasë vështirësi në një përkufizim të përgjithshëm të tyre edhe për shkak të larmisë së minoriteteve dhe në përcaktimin e karakteristikave të konsoliduara për përcaktimin e tyre. Prandaj, kur i referohemi mbrojtjes së të drejtave të komunitetit rom do t'i adresojmë problematikat e trajtuara në përputhje me përcaktimin e “diskriminimit racial” të dhënë nga ECRI, sipas të cilit kemi të bëjmë me “trajtimin ndryshe bazuar në etninë, origjinën, kombësinë, besimin fetar dhe gjuhën” (Rekomandimi Nr. 7 i ECRI për Politikën e Përgjithshme për Legjislacionin Kombëtar të Luftës kundër Racizmit dhe Diskriminimit Racial, CRI (2003)8, miratuar 13 Dhjetor 2002, paragrafët 1/ b, c). Ndërkohë Konventa Europiane e të Drejtave të njeriut jep një kuptim më të gjerë për konceptin “përkatësia etnike dhe raciale”, duke përfshirë shprehimisht edhe “kombësinë”, ndryshe nga legjislacioni i BE-së, pasi Direktiva për Barazinë Raciale shprehimisht e përjashton “kombësinë” nga koncepti i racës ose etnisë. Megjithatë jurisprudenca tregon se kombësia mund të kuptohet si një element përbërës i përkatësisë etnike (FRA, Korrik 2010, fq. 79).

Në Shqipëri, ndonëse në legjislacionin e brendshëm nuk ka një përkufizim ligjor për termin “minoritet”, njihen dy lloje minoritetesh:

- i. Minoritetet etnike kombëtare (minoriteti Grek, minoriteti Maqedonas dhe minoriteti Serbo-malazez).
- ii. Minoritetet etno-gjuhësore (minoriteti Vlleh dhe minoriteti Rom).

Megjithatë, në realitet ekzistojnë edhe komunitete të tjera siç janë komuniteti boshnjak, egjiptian dhe goran. Në këtë studim, jemi fokusuar në problematikën e ndjeshme të respektimit të të drejtave të komunitetit rom.

Sipas Censurit të vitit 2011, të realizuar nga INSTAT, rezulton se numri i përgjithshëm i popullsisë në Republikën e Shqipërisë është 2,800,138 banorë, ndërkohë që minoritetet rezultojnë me 52.700 individë, që përbën rreth 1.9 të gjithë popullsisë. Debati mbi numrin e saktë të individëve që i përkasin komunitetit rom ka qenë i vazhdueshëm. Kështu, ky debat nuk u konsolidua as në Censurin e vitit 2011. Sipas të dhënave të Censurit 2011 rezultojnë 8,301 banorë rom në Shqipëri.

Në këtë regjistrim të popullsisë u përfshi edhe pyetja mbi përkatësinë etnike si një alternativë fakultative, që nënkupton vetë-deklarimin si një kriter për identifikimin e përkatësisë etnike të popullsisë. Nga kjo pyetje,

rezultoi se (i) 390,938 banorë kanë preferuar të mos përgjigjen dhe (ii) përgjigjet e 44.144 të tjerëve kanë qenë të pavlefshme/pa përcaktim. Rezultatet e Censusit për Popullsinë dhe Banesat u kundërshtuan nga përfaqësuesit e minoriteteve, përfshirë disa shoqata Rome dhe Egjiptiane (Progres-Raport 2013 për Shqipërinë, fq. 56 ) Për një analizë të hollësishme të problematikës, propozojmë që të evidentojmë tre aspekte të rëndësishme për tu trajtuar, të lidhura ngushtësisht me respektimin efektiv të të drejtave të komunitetit rom në Shqipëri: (1) kuadri ligjor shqiptar që garanton të drejtat e komunitetit rom; (2) hartimi i politikave që synojnë reduktimin e dallimeve dhe nxitjen e zbatimit të parimit të barazisë; (3) Krijimi i kuadrit institucional për mbrojtjen e të drejtave të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri.

## **I. Krijimi i kuadrit ligjor të domosdoshëm që garanton të drejtat e komunitetit rom**

Legjislacioni shqiptar në fushën e mosdiskriminimit parashikon një sërë aktesh, duke filluar me Kushtetutën e R.Sh-së, aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe me ligjet e brendshme, të cilat renditen si më poshtë:

***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë***, ka synuar nxitjen e respektimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në disa dispozita të saj, ku mund të përmendim nenin 18, por edhe nenet 16 e 20. Në nenin 18 parashikohet se “*të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, jep mundësinë që t’i referohemi dokumenteve të rëndësishëm ndërkombëtare dhe rajonale, duke u dhënë atyre fuqi juridike që vjen menjëherë pas saj dhe duke i vendosur në radhë të dytë në hierarkinë e normave ligjore (*Kushtetuta e Shqipërisë*, neni 116). Natyrisht që ky është një kuadër mjaft i gjerë, mes të cilave mund të përmendim *Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike* dhe *Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore* ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991. Dëshirojmë të evidentojmë disa prej tyre që në mënyrë tërësore shërbejnë si bazë e rëndësishme për të hartuar një legjislacion të brendshëm që nxit parimin e barazisë në ushtrimin e të drejtave të njeriut.

***Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial - CERD***, në të cilën Shqipëria ka aderuar në vitin 1994. Konventa përcakton detyrimin e shteteve palë të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave:

- Të drejtat politike: e drejta e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta aktive dhe pasive e votës, dhe për të pasur

akses të barabartë në shërbimet publike;

- Të drejta të tjera civile: e drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti; e drejta e shtetësisë; e drejta e martesës dhe e zgjedhjes së bashkëshortit/ bashkëshortes; e drejta e pronës; e drejta e trashëgimisë; e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë; e drejta e lirisë së mbledhjes dhe krijimit të organizatave paqësore;
- Të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore: e drejta e punës; e drejta e krijimit të sindikatave dhe e anëtarësimit në to; e drejta e strehimit; e drejta e trajtimit shëndetësor, sigurimit shoqëror dhe shërbimeve sociale; e drejta e arsimit dhe përgatitjes profesionale.

***Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore***, e ratifikuar nga Shqipëria në 1996 (Ligji shqiptar nr. 8137/1996), në nenin 14 të saj parashikon “*ndalimin e diskriminimit*”. Protokollin Nr. 12, në nenin 1, i referohet ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit, duke zgjeruar fushën e zbatimit të Nenit 14 edhe në rastet kur një person është diskriminuar në gëzimin e çdo të drejte ose përfitimi sipas legjislacionit kombëtar.

Sigurisht që një vend thelbësor zë ratifikimi pa asnjë rezervë nga Shqipëria e ***Konventës Kuadër të Këshillit të Europës Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare***. Kjo Konventë ka qëllim themelor sigurimin e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Kjo konventë ndalon çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare, duke përcaktuar detyrimin për palët nënshkruese të kësaj konvente, që t’iu garantojnë personave që iu përkasin pakicave kombëtare të drejtën e barazisë para ligjit dhe të mbrojtës së barabartë nga ligji.

***Karta Sociale Evropiane***, një traktat i Këshillit të Europës, e miratuar në vitin 1961 dhe e rishikuar në vitin 1963, është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm me ratifikimin e saj prej Shqipërisë në vitin 2002. Karta Sociale Evropiane ka sanksionuar shprehimisht parimin e barazisë (neni 20) “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit*” dhe parimin e mosdiskriminimit (neni 21) “*Çdo diskriminim bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, etnia, origjina etnike apo shoqërore, gjuha, feja apo besimi, bindjet politike ose bindje të tjera, përkatësia në një minoritet kombëtar, vendbanimi, lindja, aftësia e kufizuar, mosha, orientimi seksual duhet të ndalohet*”.

**Ligji shqiptar nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”**, konkretizon nenin 18 të Kushtetutës. Ai është ligji organik mbi bazën e të cilit sigurohet mbrojtja nga diskriminimi. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi.



Ligji rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë joshteruese shkaqesh, duke përfshirë në mënyrë të shprehur racën, ngjyrën, gjuhën, besimin që janë elemente të qenësishme të një minoriteti.

Ligji shqiptar parashikon diskriminimin “për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të mbrojtura” si dhe “përkatësinë në një grup” si shkak për të cilin ofrohet mbrojtje. LMD parashikon si formë diskriminimi “*udhëzimin për të diskriminuar si një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji*”. Në këndvështrimin tonë, termi “hierarki” duhet hequr, për arsye se kjo formë diskriminimi mund të ndodhë edhe në marrëdhëniet e të njëjtit nivel. Ligji shqiptar, në fushën e strehimit i referohet “*një vendi ku ofrohet strehim*”. Meqenëse ky formulim nuk është i qartë, do të duhej të qartësohej. Gjithashtu, objekti duhet të zgjerohet në përputhje me sa parashtruar më sipër” (OSCE/ODIHR, 2013, fq. 12). Siç vëren ODHIR në një studim krahasues mbi legjislacionin anti-diskriminim, segregimi nuk mund të jetë i justifikuar në asnjë rast, por “*vihet re se ligjet e Shqipërisë, Serbisë dhe FYROM nuk parashikojnë asnjë rregullim lidhur me segregimin*” (OSCE/ODIHR, 2013, fq. 12).

Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore janë të parashikuara shprehimisht dhe përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, në fushën e arsimit, si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Por, mbrojtja nga diskriminimi sipas Ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” garantohej për të gjitha të drejtat e liritë themelore të njohura në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë si dhe me ligjet në fuqi.

Ligje të tjera gjithashtu sanksionojnë parimin e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, edhe pse ekziston nevoja për ndryshime apo miratimin e legjislacionit të ri për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi (Progres Raporti 2013 për Shqipërinë fq.58). Kryesisht është e nevojshme që të harmonizohen këto ligje me Ligjin “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, përse i takon shkaqeve për të cilat subjektet mund të mbrohen nga sjelljet diskriminuese dhe formave të diskriminimit.

## **II. Hartimi i politikave që synojnë reduktimin e dallimeve dhe nxitjen e zbatimit të parimit të barazisë**

Që të arrihet hartimi i politikave të përshtatshme dhe efektive në mbështetje të integritetit të komunitetit rom duhen mbajtur parasysh:

## ***II.1. Identifikimi i natyrës së çështjeve dhe pengesave***

Situata në të cilën jeton komuniteti rom është dukshëm diskriminuese dhe jo në përputhje me standartet që një vend demokratik duhet të ofrojë për qytetarët e vet. Diskriminimi i shumëfishtë, si një situatë ku një individ përjeton diskriminim për më shumë se një shkak, e prek shpesh këtë komunitet. Me fjalë të tjera, një person jo vetëm mund t'i përkasë një minoriteti të caktuar, por ka edhe një moshë të caktuar dhe njëkohësisht gjinia mund të shtojë vulnerabilitetin e individit për të qenë viktimë e diskriminimit (Raporti Vjetor 2013 i KMD, fq. 21). Në këtë studim, evidentohen një sërë problematikash që shfaqen kryesisht në:

- a. Ofrimin e shërbimeve në respekt të diversitetit dhe pa u diskriminuar;
- b. Arsimin;
- c. Punësimin.

### **II.1.1. Ofrimi i shërbimeve në respekt të diversitetit dhe pa u diskriminuar**

Problematikat kryesore në ofrimin e shërbimeve në respekt të diversitetit dhe pa u diskriminuar lidhen me: strehimin, përfitimin nga mbrojtja sociale, regjistrimin në gjendjen civile.

**Strehimi.** Kjo është një ndër fushat më të ndjeshme për një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të komunitetit rom, të cilët jetojnë në kushte të vështira banimi, me hapësira të pamjaftueshme, dhe në ambiente të papërshtatshme. Nga analiza e situatës evidentohet që:

- ✓ Një pjesë e njësive vendore nuk kanë ndërtuar banesa sociale,
- ✓ Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë parashikuar kuota të veçanta këtij komuniteti në mënyrë që të ngushtohet diferencimi i dukshëm me popullsinë jo-rome,
- ✓ Legjislacioni shqiptar në dukje është asnjëherë dhe respekton parimin e barazisë, por efektet sociale të tij për këtë komunitet janë të disfavorshme dhe përjashtuese. Institucionet përgjegjëse duhet të ndërhyjnë patjetër që të shmangin diskriminimin e tërthortë dhe atë substancial. Ky është qëndrimi që ka mbajtur edhe GJEDNJ në çështjen *Thlimmenos* (ECHR 6.4.2000).
- ✓ Një fenomen tjetër që po shfaqet gjithnjë e më shpesh ka të bëjë me dëbimin e familjeve rome nga trualli që i nënshtrohet zhvillimit qoftë për interesa publike, qoftë për nevojat e zhvillimit të pronës së tyre nga pronarët e tij të ligjshëm.

Kur personat vulnerabel nuk janë në gjendje të sigurojnë vetë strehim alternativ duhen mbështetur nga shteti në resurset e tij të disponueshme. Shteti duhet të mbajë parasysh që legjislacioni i brendshëm duhet të ofrojë mbrojtje nga dëbimi, veçanërisht në aspektin procedural. Asistenca procedurale përfshin sigurimin e mjeteve juridike dhe ofrimin, brenda mundësive, të ndihmës juridike për personat që kanë nevojë t'i drejtohen gjykatës për të mbrojtur të drejtat e tyre (Komenti i Përgjithshëm nr. 7, neni 11.1).

Ndonëse neni 41 i Kushtetutës së RSH-së garanton të drejtën e pronës, neni 17 i saj parashikon edhe kufizime që bëhen me ligj dhe që duhet të jenë proporcionale.

- ✓ Ligji për shpronësimet për interes publik (Ligj nr. 8561/1999) rregullon të drejtën e shtetit për të shpronësuar, mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të pronarëve përkatës dhe përcakton rastet dhe procedurat për kryerjen e shpronësimeve. Ky ligj nuk mbron personat që janë vendosur në këto prona në mënyrë informale. Mirëpo, nga ana tjetër, situata aktuale është e lidhur ngushtë edhe me procesin e legalizimit të ndërtesave informale. Ajo që vihet re është se ka raste kur Drejtoritë e ALUIZNI-t nuk kanë marrë të gjitha masat për finalizimin e procedurave për legalizimin e këtyre banesave dhe ndërhyrja e INUK dhe INUV bëhet pa pasur një përgjigje përfundimtare mbi plotësimin apo jo të kriterëve të legalizimit. Në rast të plotësimit të kriterëve të legalizimit këto familje do të përfitonin nga shpronësimet. Nga ana tjetër, legjislacioni parashikon detyrimin për të marrë masa për rehabilitimin e personave të zhvendosur. Konkretisht në nenin 21, pika 2, germa “ë” të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009, “*Për planifikimin e territorit*”, i ndryshuar, përcaktohet se: “***Planet, në përputhje me territorin objekt të planifikimit, përmbajnë si element programin e rehabilitimit të personave të zhvendosur, si pasojë e zbatimit të planit***”.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut i ka trajtuar çështjet e shpërnguljeve me forcë në kuadrin e nenit 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, duke mbështetur respektin për banesën, jetën private dhe familjare. Megjithëse kjo Konventë nuk e detyron shtetin të sigurojë shtëpi, në çështjen *Yordanova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (ECHR 5.6.2012), GJEDNJ urdhëroi autoritetet bullgare të pezullonin dëbimin në pritje të përfundimit të procedurave para gjykatës. Në këtë vendim ndikoi dukshëm edhe fakti që flitej për një numër të konsiderueshëm individësh të vendosur për një kohë të gjatë në mënyrë informale dhe për mungesën e një vlerësimi nga ana e institucioneve lokale mbi efektet që do të sillte në zhvillimin e territorit dëbimi me forcë i banorëve rom (ECHR 5.6.2012). Mbrojtja e komunitetit rom nga dëbimet me forcë është sjellë në vëmendje edhe nga Agjencia e Bashkimit European për të Drejtat Themelore -FRA (European Union Agency for Fundamental Rights FRA, Mars 2010, fq. 138).

***Akresi në mbrojtjen sociale.*** Mbrojtja sociale është e lidhur ngushtë me kriteret për përfitim e saj, të cilat, si në rastin e përfitimit nga strehimi, kërkon ndërhyrje në përcaktimin e kriterëve të domosdoshme për t’u përfshirë në këtë sistem.

Nga ankesat e trajtuara nga KMD, të cilat paraqiten nga pjesëtarë të komunitetit Rom, shihet domosdoshmëria për të informuar këtë komunitet mbi procedurat e aplikimit të ndihmës ekonomike apo të përfitimit nga banesat sociale.

## Çështje KMD

### Çështja ex-officio e dëbimit të familjeve rome nga vendstrehimi i tyre, pranë Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit në Rrugën e Kavajës:

Gjatë muajit gusht të vitit 2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndjekur me prioritet rastin e dëbimit të familjeve rome nga vendstrehimi i tyre pranë rrugës së “Kavajës”. Gjatë takimit me anëtarë të komunitetit rom që jetonin në këto vendbanime, inspektorët morën informacion se në këtë zonë jetonin rreth 37 familje të komunitetit rom. Sipas informacionit të marrë prej tyre, një pjesë e tyre ishte vendosur që prej vitit 1990 në këtë zonë. Lidhur me këtë rast, më datë 07.08.2013, Komisioneri i ka dërguar **rekomandim Bashkisë së Tiranës** për marrjen e masave të menjëhershme për ofrimin dhe zbatimin e programeve të strehimit social për familjet Rome, pranë Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit në Rrugën e Kavajës, dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, të ndërmjetësojë me institucionet e varësisë për të bërë të mundur ofrimin e ndihmës ekonomike për familjet rome, të cilat janë banorë të Bashkisë Tiranë. Theksojmë se, për shkak të kriterëve ligjore për përfitimin e ndihmës ekonomike, nga 11 familje që u asistuan nga KMD, vetëm 1 familje përfitoi ndihmë ekonomike.

Gjatë shpërnguljes, pjesëtarët e familjeve rome të shpërngulura nga rruga e Kavajës, ngritën shqetësimin se organet e policisë nuk kishin reaguuar ndaj shpërnguljes forcërisht që u ishte bërë dhe abuzimeve verbale ndaj tyre. Nuk u gjet asnjë dokumentacion që të vërtetojë se janë ndjekur të gjitha veprimet që parashikon legjislacioni shqiptar për lirim të truallit të zënë padrejtësisht. Nga ana tjetër, nuk ka asnjë informacion mbi masat që institucionet përgjegjëse për t’u kujdesur për strehimin kanë marrë për të shmangur pasojat negative për këtë komunitet. Kështu, Komisioneri i dërgoi po në datën 07.08.2013 një **rekomandim Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë**, ku kërkoi marrjen në mënyrë të menjëhershme të masave të nevojshme për trajtimin e çështjes në mënyrë ligjore, të barabartë dhe jo-diskriminuese.

## Çështje KMD

Në vitin 2012, KMD ka **konstatuar diskriminim** ndaj tre banorëve të Komunës Grabian, për shkak të vendbanimit, duke qenë se atyre nuk i ofrohej shërbimi i ndihmës ekonomike nga ana e Komunës, për shkak të interpretimit të gabuar të legjislacionit përkatës.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, bazuar në ankesat e paraqitura pranë këtij institucioni nga pjesëtarë të komunitetit rom dhe çështje të nisura me iniciativën e Tij, ka konstatuar problematikën që kanë të bëjnë me çështjen e strehimit, moszgjidhje e të cilave çon në mos-përfitimin e ndihmës ekonomike, punësimin etj (për më shumë informacion, shih **Raportin e Veçantë të Avokatit të Popullit “Problematikat e komunitetit rom gjatë 6**

*-mujorit të parë të vitit 2012, dhe trajtimi i tyre nga Avokati i Popullit"* (faqe 3) i cili është i vlefshëm në link: [http://www.parlament.al/web/pub/2012\\_raporti\\_per\\_romet\\_15416\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_romet_15416_1.pdf))

**Regjistrimi në regjistrat e gjendjes civile.** Mos-regjistrimi i fëmijëve në regjistrat e gjendjes civile është një problematike për fëmijët rom në Shqipëri. Mosregjistrimi i fëmijëve rom dhe egjiptian, minimizon aksesin e tyre në gëzimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore (CESCR, 2013, fq.4).

Bazuar në ankesat e paraqitura nga pjesëtarë të komunitetit rom, Avokati i Popullit ka konstatuar se në shumë raste këta shtetas nuk figurojnë të regjistruar në gjendjen civile pranë vendbanimit të tyre. Regjistrimi i tyre do të bënte të mundur aksesin në përfitimet ligjore. Shumica e familjeve rom nuk përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nuk përfitojnë të ardhurën nga papunësia, nuk mund të aplikojnë për të përfituar nga programet sociale të banesave, si dhe shumë të drejtave, që gëzojnë pjesa tjetër e popullsisë. Mospërfitimi i këtyre të drejtave vjen si pasojë e mosregjistrimit të tyre në gjendjen civile, si dhe për shkak të lëvizjes së vazhdueshme nga një vend në tjetrin. Duke marrë shkas nga kjo, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrin të Brendshëm: *Marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom në regjistrat e gjendjes civile dhe lehtësimin e procedurave të transferimit të të dhënave të gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin e ri* (për më shumë informacion, shih **Raportin e Veçantë të Avokatit të Popullit "Problematikat e komunitetit rom gjatë 6 -mujorit të parë të vitit 2012, dhe trajtimi i tyre nga Avokati i Popullit"** (faqe 6 - 7) i cili është i vlefshëm në link: [http://www.parlament.al/web/pub/2012\\_raporti\\_per\\_romet\\_15416\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_romet_15416_1.pdf))

## II.1.2. Arsimi

Ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", parashikon detyra të posaçme për Ministrinë e Arsimit dhe përcakton shprehimisht nxjerrjen e akteve nënligjore për eliminimin e diskriminimit në fushën e arsimit. Pavarësisht se Ligji "Për arsimin para-universitar" dhe aktet nënligjore përkatëse lehtësojnë regjistrimin e fëmijëve rom në shkolla edhe pa çertifikatë lindje, është vëne re një hezitim nga ana e shkollave 9-vjeçare për të zbatuar këtë rregull. Projekti "shansi i dytë" përcakton mundësinë e shkollimit edhe kur nuk është realizuar në kohën e duhur. Megjithatë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në disa raste ka evidentuar shkolla që kanë kundërshtuar që të pranojnë nxënës që u përkasin këtyre komuniteteve.

## Çështje KMD

### Çështja ex-officio e shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”.

Në vitin 2013, bazuar në informacionin e marrë nga përfaqësues të shoqatës “CRCA” në Tiranë, ku pretendohet për diskriminim të nxënësit të klasës së tretë të shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza” Tiranë, nga ana e Drejtorisë së shkollës për shkak se është fëmijë rom, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes. Rezultonte se fëmija me emrin D.D, i cili i përket komunitetit rom në Tiranë, nuk ishte pranuar për t’u regjistruar në shkollën 9-vjeçare “Shyqyri Peza” nga ana e drejtoreshës, me pretendimin se “është në moshë më të rritur se të tjerët”. Për të verifikuar pretendimet, Komisioneri vijoi procedurat e hetimit të kësaj çështje. **Përmes ndërmjetësimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Drejtorinë e shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”, Shoqatën “CRCA” dhe Qendrën Ditore “Princi i vogël”, u arrit qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore, pikërisht regjistrimi i nxënësit në klasën e tretë të shkollës 9- vjeçare “Shyqyri Peza”, Tiranë.**

Institucionet arsimore duhet të jenë të vëmendshme për të shmangur rastet e segregimit të cilat mund të ndodhin edhe për shkak se komuniteti rom është i vendosur në disa zona të caktuara dhe fëmijët e tyre shkojnë në të njëjtën shkollë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar gjatë vitit 2013 një monitorim për të parë shpërndarjen e nxënësve rom në shkollat 9-vjeçare në Tiranë. Komisioneri konstatoi se nuk kishte ndonjë tendencë të veçimit apo përqendrimit të fëmijëve rom në një shkollë të vetme (KMD 2013, faqe 52). Mjaft e përhapur është edhe situata e braktisjes së shkollës nga ana e nxënësve romë. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ka dalë me shqetësimin për mungesën e masave për të adresuar në mënyrë efektive normat më të larta të braktisjes së arsimit fillor nga vajzat, në krahasim me djemtë, gjë që ndikon në mënyrë disproporcionale tek fëmijët romë (CESCR, 2013, fq.4).

Për të garantuar të drejtën e fëmijëve dhe për të siguruar akses të barabartë, Drejtoritë Arsimore Rajonale kanë për detyrë të zbatojnë me përparësi për komunitetin rom dy udhëzimet e Ministrisë së Arsimit: (1) Udhëzimin nr. 29, datë 02.08.2013 *“Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme”* dhe (2) Udhëzimin nr. 30, datë 02.08.2013, *“Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë”*.

### **II.1.3. Punësimi**

Romët kanë problematika të dukshme në punësim. Pavarësisht se romët janë të përfshirë në planet e veprimit të pushtetit vendor ose në strategjitë kombëtare, ku parashikohet nxitja e punësimit të romëve, numri i të papunëve ngelet i lartë. Duhet theksuar se të rinjtë rom tashmë po arsimohen edhe në nivelet pasuniversitare. Në kuadër të kësaj problematike disa nga rekomandimet e fundit i janë drejtuar Zyrës Rajonale të Punësimit Shkodër, Bashkisë Kukës dhe Lezhë për nxitjen e punësimit të romëve dhe Egjiptianëve.

Edhe në konkluzionet e Komitetit të drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, është theksuar se mungesa e aksesit të romëve në punësim është edhe si pasojë e faktit, që prioritetet shtetërore nuk zbatohen në nivel lokal (CESCR 2013, fq. 3).

### ***II.2. Përcaktimi i prioriteteve kryesore dhe promovimi i praktikave të mira***

Në kuadër të zbatimit të legjislacionit të cituar në çështjen e parë të këtij raporti, janë hartuar dhe dokumente strategjike dhe politika mos-diskriminimi, ku përmendim: Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013; Plani Kombëtar i Veprimit për Dekadën e Përfshirjes Rome 2012-2015. Ndërkaq, është në proces hartimi i Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale për vitet 2015 – 2020 nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Hartimi i këtyre dokumenteve është një sfidë e vërtetë, që ka lidhje me marrjen e masave pozitive për të nxitur integrimin e komunitetit rom dhe zbatimin e parimit të barazisë. Një nga këto masa, të propozuara në mënyrë të vazhdueshme nga Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka qenë ndryshimi i legjislacionit që do të mundësonte përfshirjen në sistemin e mbrojtjes sociale apo regjistrimin.

Ligji “Për mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon detyrimin e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit për marrjen e masave pozitive për të nxitur arsimimin e pakicave apo vajzave, që do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në nivelin e arsimimit të këtij komuniteti. Duhet theksuar se janë marrë disa masa të tilla si përjashtimi i studentëve romë nga tarifa e shkollimit apo pajisja falas me libra të fëmijëve rom në arsimin para-universitar etj.

## Çështje KMD

Çështja ex-officio e studentëve Rom, lidhur me përjashtimin e tyre nga tarifat e regjistrimit të studentëve, në Universitetin e Korçës.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, filloi ex-officio çështjen, pas një informacioni të marrë se gjashtë studentë të komunitetit Rom, që ndiqnin studimet universitare në Universitetin e Korçës, nuk ishin përjashtuar nga tarifat e regjistrimit në Universitetin e Korçës, sipas përcaktimeve në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave. Studentët ishin regjistruar në Universitet, por nuk i lejonin të hynin në provime pa paguar tarifën shkollore për vitin akademik përkatës.

Në bashkëpunimin me Shoqatën “Disutni Albania” dhe Shoqatën “Qëndistarët”, të cilit kishin ngritur këtë shqetësim, dhe ndërmjetësimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Universitetin e Korçës Fan S. Noli, u arrit që të realizohej përfshirja e 11 studentëve rom, në listën e studentëve që përfitojnë përjashtimin nga pagesa e tarifës së shkollimit.

### III. Krijimi i kuadrit institucional për mbrojtjen e të drejtave të romëve në Shqipëri

Shqipëria tashmë ka hartuar një legjislacion në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe ka krijuar mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi të komunitetit Rom. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka parashikuar krijimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kompetencat e të cilit janë në përputhje me Direktivën 2006/54/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, i cili në nenin 20 parashikon se këto organe ndër të tjera duhet të sigurojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit përmes trajtimit të çështjeve apo asistencës në gjykatë. Ky proces është i lidhur ngushtë me *“asistencën ndaj viktimave, përcaktimin e kriterëve të dobishme për evidentimin e rasteve që duhen mbështetur, kështu çështja do të kishte efekt në momentin e zgjidhjes përtej rastit konkret”* (European Network of Equality Bodies, 2010, fq. 4).

Në Raportin Analitik të vitit 2013 për Shqipërinë, theksohet angazhimi që duhet të ketë vendi ynë në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit, për të përmirësuar shpejt kushtet e jetesës të komunitetit Rom. Për këtë është thelbësor koordinimi i administratës publike në nivel qendror dhe vendor (Progres Raport 2013 për Shqipërinë, fq.52-57).

Megjithatë, Organet Europiane të Barazisë dhe Mosdiskriminimit, kanë përcaktuar disa aspekte që duhet të mbajnë parasysh gjatë trajtimit dhe monitorimit të respektimit të të drejtave të komunitetit Rom (EQUINET -



Rrjeti European i Organeve të Barazisë, 2010, fq.13-14). Këto aspekte janë të lidhura me:

- Rritjen e kapaciteteve për të trajtuar problematika ndërkulturore apo krijimit të hapësirave, përmes identifikimit të tyre si mbrojtës të komunitetit;
- domosdoshmërinë e edukimit për legjislacionin anti-diskriminim përmes strategjive të informimit.

### ***III.1. Identifikimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si mbrojtës i komunitetit në trajtimin e problematikave të komunitetit rom***

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucioni, i cili *“siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”* (Neni 21, pika 1). Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit (Neni 22). Nëse i referohemi kompetencave që ligji i njuh këtij institucioni, i një rëndësie të veçantë është *ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit në trajtimin e ankesave të tyre për diskriminim*, ku përfshihen: shqyrtimi i ankesave nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar ose nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi; kryerja e hetimeve administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të ligjit; vendosja e sanksioneve administrative sipas përcaktimit të këtij ligji; parashtrimi i mendimit me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin e investuar në saje të kërkesës së gjykatës që shqyrton çështjen; përfaqësimi i ankuesit në organet gjyqësore në çështjet civile me miratimin e tij në përputhje me pikën 3 të nenit 34 të këtij ligji.

Procedura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me plotësimin e një ankese. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal(neni 33 i ligjit). Ankesa duhet të ketë informacion lidhur me viktimën e diskriminimit, informacion mbi identifikimin e subjektit i cili pretendohet të ketë kryer diskriminim si dhe shpjegime dhe fakte që disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri. Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij. Komisioneri nuk vepron për ankesat anonime.

Në qoftë se ankesa plotëson kushtet e ligjit për t’u pranuar ajo i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm bazuar në nenin 33 të ligjit. Procedura e hetimit përfshin grumbullimin e informacionit lidhur me çështjen, mund të zhvillohen edhe inspektive apo seanca dëgjimore mes palëve. Pas analizimit të fakteve të grumbulluara

bazuar ne procedurën e hetimit, Komisioneri del me vendim pas 90 ditëve nga data e ardhjes se ankesës, apo e seancës dëgjimore, nëse është zhvilluar një e tillë. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa, nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

Si mjet të fundit, kur subjekti fizik ose juridik nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas Kodit të Procedurës Civile.

### **III.1.1. Edukimi për legjislacionin anti-diskriminim përmes strategjive të informimit**

Ndërgjegjësimi është një komponent i rëndësishëm në veprimtarinë e institucioneve të barazisë dhe mosdiskriminimit. Komisioni European në Raportin Analitik të vitit 2013 për Shqipërinë, ka theksuar se “*ndërgjegjësimi i publikut për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe mekanizmi i ankesës mbetet i ulët*”.

KMD ka në kompetencë *rritjen e ndërgjegjësimit*, ku përfshihen: nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdo çështjeje që lidhet me diskriminimin; informimi për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Në zbatim të Planit Strategjik 2012-2015, KMD ka përcaktuar si prioritet strategjik *rritjen e ndërgjegjësimit të*

*opinionit publik për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për rolin e KMD-së në këtë fushë.* Ndërsa, si objektivi specifik është parashikuar *rritja e numrit të ankesave të komunitetit rom dhe atij egjiptian në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve si dhe në fushën e punësimit.*

Sjellim në vëmendje si më poshtë disa aktivitete:

- **Organizimi i Konferencave dhe trajnimeve nga KMD**

Me datë 19 mars 2013, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racial, Komisioneri organizoi tryezën e rrumbullakët me temë: “**Diskriminimi Racial dhe sfidat e zbatimit të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”**”. Qëllimi i këtij takimi ishte të tërhiqte vëmendjen e institucioneve, shoqërisë civile dhe mediave ndaj të drejtës së personave të komunitetit rom dhe egjiptian, për të marrë në mënyrë të përshtatshme shërbimet në edukim, punësim dhe të mira. Gjatë këtij aktiviteti u nënshkruan 11 Marrëveshje Bashkëpunimi midis Komisionerit dhe OJF-ve pjesëmarrëse, që mbrojnë të drejtat e këtyre komuniteteve në Shqipëri.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizoi, me datë 7 nëntor 2013, **Konferencën “Mbrojtja nga diskriminimi: Modelet pozitive dhe sfidat”**. Konferenca kishte për qëllim të tërhiqte vëmendjen e institucioneve, shoqërisë civile, mediave dhe organizmave ndërkombëtarë ndaj të drejtës për mbrojtje nga diskriminimi, arritjeve dhe sfidave në këtë fushë. Konferenca është realizuar përmes gjashtë grupeve pune: për mbrojtjen nga diskriminimi me bazë gjinore, mbrojtjen nga diskriminimi të fëmijëve, minoriteteve, komunitetit LGBT, personave me aftësi të kufizuar dhe një tryezë ka diskutuar lidhur me sfidat e zbatimit të ligjit 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Anëtarët e shoqatave romë dhe egjiptiane kanë ngritur gjatë Konferencës problematikat e mëposhtme: - Komuniteti Rom ka problematika në fushën e strehimit; - Ndhurma ekonomike e cila përfitohet nga ky Komunitet është shumë e vogël; - Media duhet të jetë me e ndjeshme ndaj problematikave të romëve; - Duhet të hartohet një strategji e posaçme për egjiptianët; - Kuotat në universitete janë shumë të ulta për romet dhe egjiptianët; - Ka shumë burokraci në marrjen e vërtetimit të papunësisë në kuadër të marrjes së ndihmës ekonomike.

- **Organizimi i Ditëve të Hapura**

Ditët e hapura të realizuara nga KMD janë parashikuar si një nga komponentët e tre projekteve që po implementohen në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të kombëtare (OSCE/ODHIR, UNDP, KShH). Ditët e Hapura realizohen nëpërmjet *sesioneve informuese* dhe takimeve të drejtpërdrejta

me komunitetin me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për mbrojtjen nga diskriminimi, *parashtrimit të problematikave nëpërmjet ankesave* të çdo komuniteti, të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e numrit të ankesave të paraqitura dhe të shqyrtuara nga KMD.

Në total, ***KMD ka realizuar 29 Ditë të Hapura*** me komunitetet vulnerabël, duke përfshirë këtu edhe komunitetin rom. Gjatë vitit 2012, KMD ka zhvilluar 10 (dhjetë) Ditë të Hapura, në të cilat kanë marrë pjesë rreth 385 pjesëmarrës nga grupe të ndryshme vulnerabël. Gjatë vitit 2013, KMD ka zhvilluar 9 (nëntë) Ditë të Hapura, në të cilat kanë marrë pjesë 355 pjesëmarrës nga grupe të ndryshme vulnerabël. Gjatë muajit shkurt 2014, janë realizuar 3 takime ndërgjegjësuese me komunitetin rom/egjiptian, Berat, Pogradec, Vlorë (aktivitete të mbështetura nga projekti “*Për Mbështetjen e Përfshirjes Sociale të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane*” (SSIREC). Gjatë periudhës nëntor 2013 – shkurt 2014, u zhvilluan 4 Ditë të Hapura në Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Kukës (në kuadër të projektit “*Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar*”, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) në partneritet me KMD, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë). Gjatë muajit dhjetor 2014, janë zhvilluar 3 takime ndërgjegjësuese në Tiranë.

Gjatë Ditëve të Hapura janë shpërndarë Fletëpalosje dhe Broshura Informuese mbi Ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, në gjuhët e pakicave dhe në formate të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

- **Rritja e vizibilitetit në media**

Komisioneri dhe stafi i KMD-së kanë marrë pjesë në disa emisione televizive ku trajtohen problematikat sociale, që kanë të bëjnë me barazinë dhe mosdiskriminimin, nga ku mund të përmendim: “*Urbanika*” (A1 Report), “*Me zemër të hapur*” (News 24), “*Pasdite në Top Channel*”, “*Dita ime*” (Vizion Plus), “*Target*” (Albanian Screen), “*Duel*” (Tvsh), Radio Albania News etj. Gjithashtu, janë bërë deklarata për shtyp lidhur me disa çështje, siç janë: rritja e dhunës ndaj grave, rastet e pedofilisë, apo aspekte të tjera të veprimtarisë së KMD si rastet e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Postën Shqiptare, nëpërmjet të cilave do të lehtësohet shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese në zonat më të thella të vendit. Komisioneri ka botuar disa artikuj në shtypin dhe ka zhvilluar intervista speciale, si e ftuar, në edicionet qendrore informative në ABC News, Ora News dhe Albanian Screen.

*Prodhimi i një spoti publicitar dhe transmetimi në TV*

Një spot televiziv për të rritur ndërgjegjësimin e opinionit publik për ligjin dhe kompetencat e Komisionerit është përgatitur në kuadër të projektit të OSCE-ODIHR “*Best Practices for Roma Integration*” dhe është transmetuar nga data 11-18 shkurt 2013 në dy televizione kombëtare, përkatësisht: Tv Klan dhe Top Channel.

- **Pjesëmarrja në seminare, konferenca dhe tryeza diskutimi**

Komisioneri si dhe stafi i KMD-së kanë marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në konferenca dhe tryeza diskutimi mbi diskriminimin në fushën e punësimit, barazinë gjinore, ushtrimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara, përfshirjen sociale të minoritetit rom në Shqipëri, të drejtat e komunitetit LGBT. Nga këto, veçojmë: Në datat 25-27 shtator 2013, Komisionerja mori pjesë në konferencën rajonale “*Sfida të Posaçme në Shqyrtimin e Ankesave mbi Diskriminimin në Baza Etnike- Shkëmbim i Përvojave të Praktikantëve nga Rajoni*”, të zhvilluar në Ohër në kuadër të projektit “*Praktikat më të mira për Integrimin e Komunitetit Rom*”, financuar nga OSBE/OHDIR. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet përfaqësuesve të organeve të barazisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga rajoni.

- **Leksione te Hapura**

Gjatë 2013, Komisioneri ka zhvilluar 2 (dy) leksione të hapura “*Mbi Rolin e Komisionerit si garant ndaj sjelljeve diskriminuese*”, në Universitetin i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, brenda Modullit “*Administrata Publike dhe Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut*”. Ndërsa gjatë 2014, Komisioneri ka zhvilluar 7 (shtatë) Leksione të Hapura me të njëjtën temë në Universitetin i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

### **III.1.2. Kryerja e sondazheve dhe monitorimeve të pavarura në lidhje me diskriminimin**

Këtu përfshihen: kryerja e sondazheve në lidhje me diskriminimin dhe monitorimi i zbatimit të këtij ligji.

Duke marr shkas nga një çështje, e shqyrtuar me iniciativën e KMD-së, në fillimin e vitit shkollor 2011-2012, lidhur me grumbullimin/veçimin në një klasë vetme të nxënësve romë, në një shkollë 9-vjeçare të Tiranës, KMD ka realizuar, gjatë vitit 2013, një monitorim për të parë shpërndarjen e nxënësve rom në të gjitha shkollat 9-vjeçare të Tiranës. Pas analizës së bërë, KMD konstatoi se ***nuk kishte ndonjë tendencë të veçimit apo përqendrimit të fëmijëve rom në një shkollë të vetme***, por duke qenë se vendbanimet e komunitetit rom janë të përqendruara më pranë shkollave të caktuara, rrjedhimisht edhe numri i fëmijëve rom të regjistruar në këto shkolla është më i madh. Lidhur me këtë çështje Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandoi Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, të ndjekë në vazhdimësi frekuentimin e fëmijëve

të komunitetit rom në shkollat 9-vjeçare dhe ndryshimin e raportit mes nxënësve të komunitetit rom dhe atyre jo rom, në shkollat që kanë numër më të madh të fëmijëve të komunitetit rom (për t'u njohur me hollësi me këtë monitorim, shih botimin **“Përmbledhje e Vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”** në linkun: <http://kmd.al/skedaret/1431963005-KMD%20mars.pdf>).

### **III.1.3. Publikimi i raporteve dhe dhënia e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin**

Këtu përfshihen: adresimi i rekomandimeve autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues; publikimi i raporteve dhe përgatitja e rekomandimeve për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; kontribuimi në raportime dhe, sipas rastit, prezantimi i raporteve para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë.

Në zbatim të nenit 32, pika 1/f ku parashikohet kompetenca e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi *“për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”*, janë dërguar këto rekomandime:

1. Me datë 06.09.2013, KMD i ka dërguar rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave *“për marrjen e masave urgjente për miratimin e udhëzimit të përbashkët midis Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave, për të siguruar kompensimin e çmimit të teksteve shkollore, për vitin shkollor 2013-2014 në sistemin arsimor para-universitar”*, me qëllim parandalimin e gjenerimit të situatave diskriminuese për kategoritë e nxënësve vulnerabël, si fëmijët rom dhe egjiptian apo kategori të tjera nxënësish që ndodhen në kushteve të vështira ekonomike. Ky akt do të lejonte çeljen e fondit për të siguruar kompensimin e çmimit të teksteve shkollore për kategoritë vulnerabël të nxënësve.
2. Duke patur parasysh situatën në të cilën gjenden grupe të caktuara nxënësish dhe për të garantuar në baza të barabarta me të tjerët të së drejtës për arsimim të fëmijëve, KMD, me datë 05.09.2013 ka dërguar *“rekomandime për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim, në fillimin të vitit shkollor 2013-2014 në sistemin arsimor para-universitar”*, të gjitha Drejtorive Rajonale Arsimore të Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Nëpërmjet kësaj shkrese, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u ka rekomanduar Drejtorive Rajonale Arsimore, ndër të tjera:
  - zbatimin me efikasitet të udhëzimit të Ministrit të Arsimit Nr. 6, datë 29.03.2006 *“Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje”*, në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë të qeverisjes vendore, për të bërë të mundur regjistrimin e fëmijëve romë për vitin shkollor 2013-2014, pranë njësiteve vendore ku ata banojnë pavarësisht nëse ata janë të regjistruar në gjendjen civile.

- zbatimin dhe monitorimin e të gjitha masat e përcaktuara për sigurimin e teksteve dhe mjeteve shkollore falas për fëmijët romë që ndjekin arsimin e detyruar, në përmbushje të Planit Kombëtar të Veprimit të Dekadës së Përfshirjes Rome, 2010-2015.
  - të kujdesen dhe të marrin masat e duhura për të evituar veçimin dhe segregimin e fëmijëve romë në zona, shkolla apo klasa të caktuara.
  - të zbatojnë dhe monitorojnë të gjitha masat e përcaktuara për të evidentuar numrin e fëmijëve romë, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor para-universitar, sipas largësisë së qendrës së banimit me shkollën dhe të bëjnë propozimet pranë institucioneve përgjegjëse për sigurimin e transportit falas për këta fëmijë.
  - të zbatojnë me përparësi për komunitetin Rom edhe udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 29, datë 02.08.2013 “*Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme*” dhe udhëzimin nr. 31, datë 02.08.2013, “*Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë*”.
  - të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme masat që marrin drejtuesit e institucioneve arsimore për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin në shkolla, dhe mënyrën e trajtimit të sjelljeve dhe qëndrimeve homofobike dhe stigmatizuese dhe diskriminuese ndaj nxënësve që i përkasin komunitetit LGBT, nxënësve të përkatësisë rome dhe egjiptiane, dhe nxënësit me aftësi të kufizuara.
3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ka dërguar autoriteteve qendrore dhe vendore përgjegjëse **14 rekomandime për përmirësimin e situatës për grupet vulnerabël**, kryesisht për komunitetin rom/egjiptian. Problematikat në të cilat fokusoheshin këto rekomandime drejtuar autoriteteve kompetente kishin të bënin me: - *nxitjen e programeve të punësimit nga Zyrat Rajonale të Punësimit dhe Bashkitë përkatëse, duke i rekomanduar këtyre të fundit që të ndërmjetësojë me bizneset private të kontraktuara nga vetë Bashkia për nxitjen e punësimit dhe marrjen e veprimeve pozitive për këtë qëllim, përmes vendosjes së kuotave*; - *marrjen e masave për sistemimin e tregtarëve rom në vende ku ata mund të ushtrojnë aktivitetin tregtar në mënyrë të barabartë me të tjerët*; - *marrjen e masave për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit rom në regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual*; - *marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve që cenojnë dinjitetin e individit për shkak të përkatësisë së tij etnike dhe trajtimin me efektivitet të denoncimeve të bëra nga qytetarët pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike*; - *për trajtimin me përparësi të familjeve rome për përfitimin e banesave sociale me qera*; - *për ndërtimin e një mbikalimi për banorët e komunitetit egjiptian, me qëllim minimizimin e rrezikut të jetës*;

- marrjen e masave për sistemimin e kabllave të amortizuara të energjisë elektrike në lagjen ku banojnë komunitet egjiptian.

#### 4. Seancat Publike në Kuvendin e Shqipërisë

23.10.2013 - *Seancë dëgjimore për masat e marra për strehimin e familjeve romë dhe për pagesat e Personave me Aftësi të Kufizuara* në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Duke qenë se romët dhe personat me aftësi të kufizuara janë dy nga kategoritë me të cilët KMD zhvillon pjesën më të madhe të punës, Komisionerja theksoi problematikat e këtyre grupeve vulnerabël si dhe rekomandimet nxjerra për përmirësimin e situatës së tyre.

13.11.2013 - *Seancë dëgjimore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri*, zhvilluar nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Komisionerja prezantoi aktivitetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, i fokusuar në: ndërgjegjësim të komunitetit të shoqërisë në tërësi dhe trajnim të aktorëve të përfshirë monitorime dhe asistencë ndaj fëmijëve, me fokus fëmijët e rrugës, viktimat të diskriminimit; arsimimi i vajzave romë; rekomandime të KMD (legjislative apo për çështje të veçanta diskriminimi).

#### IV. Bashkëpunimi me aktorët e tjerë

- Projekti i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, implementuar nga **ODIHR**, në kuadër të projektit rajonal (EU) – OSCE – ODIHR, me temë: ***“Praktikat më të mira për integrimin e komunitetit rom”***

Objektivat e projektit:

1. Forcimi i kapaciteteve të aktoreve shtetërore duke përfshirë Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore për sigurimin e barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi;
2. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian mbi Ligjin *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* dhe Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi
3. Krijimi dhe forcimi i lidhjeve midis Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe njërive të qeverisjes lokale për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Kjo lidhje dhe bashkëpunim fillon me caktimin e një personi si pikë kontakti në strukturën



e bashkisë/komunës dhe me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit, të nënshkruar mes KMD dhe njësisve të qeverisjes vendore përkatëse;

4. Mbështetje për organizimin e Ditëve të Hapura në Zyrat e qeverisjes vendore, nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të shpjeguar banorëve lokal, duke përfshirë romët dhe egjiptianët, mënyrën se si mund të ankohen tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Aktivitetet e ndërmarra në kuadër të këtij projekti:

- Prodhimi dhe shfaqja e një Spoti televiziv me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë mbi ligjin dhe kompetencat e KMD
- Organizimi i Ditëve të Hapura në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore në 7 bashki dhe komuna (ditët e hapura në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar në: Bashkinë Lezhë, Komunën Shushicë, Bashkinë Lushnje, Komunën Grabian, Bashkinë Pogradec, Bashkinë Gjirokastër dhe Bashkinë Tiranë).
- Gjatë zhvillimit të Ditëve të Hapura, Komisioneri nënshkroi Marrëveshje Bashkëpunimi me Kryetarët e Bashkive apo komunave respektive duke vendosur edhe një pikë kontakti nga stafi i KMD-së, në mënyrë që autoritetet vendore të referojnë raste tek zyra e Komisionerit.
- Fushata ndërgjegjësimi 2-ditore.
- Projekti me temë: **“Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar”** i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë.

Ky projekt synonte të rritet aksesimi i qytetarëve tek zyra e Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nëpërmjet OJF-ve dhe organeve të qeverisjes vendore si dhe të rritet ndërgjegjësimi për Ligjin *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* dhe zbatimin e tij i plotë nga të gjithë aktorët e përcaktuar në ligj. Në kuadër të projektit janë zhvilluar *sesione informues* mbi ligjin *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* me përfaqësues të organeve të pushtetit vendor, Drejtorive Rajonale të Arsimit, Drejtorisë Rajonale të Punësimit dhe përfaqësues të personelit pedagogjik të shkollave, u realizuan *Ditë të Hapura* për komunitetin qytetar, ku u zhvilluan takime të drejtpërdrejta dhe u morën ankesa nga qytetarët, si dhe *programe televizive* në mediat lokale. Gjithashtu, është përgatitur një Manuali i Trajnimit: **“Mbrojtja nga Diskriminimi – Manual Trajnimi për OJF-të”**, i cili ka përfunduar në gusht 2013.

- Projekti i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, implementuar në bashkëpunim me **PNUD**, me temë: **“Zbatimi i parimit të barazisë gjinore dhe programit të dhunës me bazë gjinore”**

Qëllimi i këtij projekti është *“Rritja e efektivitetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në trajtimin*

*e çështjeve të diskriminimit me bazë gjinore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve profesionale të stafit të tij dhe ngritja e ndërgjegjësimit të komunitetit’.*

Aktivitetet që janë ndërmarrë në kuadër të këtij projekti:

- Vizita studimore të stafit profesional të Zyrës së Komisionerit në zyrat homologe, të planifikuara për t’u realizuar me qëllim njohjen dhe marrjen e praktikave më të mira për adresimin e çështjeve të diskriminimit.
- Jurisprudencë e përkthyer në shqip të vendimeve historike të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës Europiane të Drejtësisë, Komitetit CEDAW dhe institucioneve të barazisë, veçanërisht nga Shtetet e Europës Perëndimore, mbi çështjet e barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit, të cilat synojnë që ti shërbejnë si referencë stafit të KMD-së për zgjidhjen e çështjeve.
- Me qëllim rritjen e profesionalizmit të stafit të KMD-së, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2013, KMD është asistuar në veprimtarinë e tij nga një Grup Ekspertësh (i përbërë nga 4 studiues të së drejtës dhe një ekspert ndërkombëtar, me eksperiencë në institucionet e barazisë) të fushës së diskriminimit. Roli i këtij grupi konsiston në analizimin dhe këshillimin mbi çështje dhe vendime të Komisionerit që i përkasin fushës së diskriminimit, për shkaqe të ndryshme.
- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për mbrojtjen nga diskriminimi përmes organizimit 10 Ditë të Hapura në: Tiranë, Durrës, Fier, Skrapar, Përmet, Sarandë, Tropojë, Lezhë, Burrel, Shkodër. Organizimi i këtyre takimeve synon që të të informojnë dhe të ndërgjegjësojë popullsinë mbi rolin e KMD-së si dhe të rrisë numrin e ankesave që do të paraqiten në Zyrën Komisionerit apo në Gjykatë. Në këto Ditë të Hapura janë formalizuar edhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Kryetarët e Bashkive respektive.

Media është përdorur si një mjet për informimin e publikut mbi legjislacionin anti-diskriminim dhe t’i inkurajojë ata që të përdorin shërbimet e Komisionerit. Trajnimi i gazetarëve për raportimin e çështjeve të diskriminimit është një tjetër aktivitetet i cili është zhvilluar në zbatim të këtij projekti. Pjesëmarrja në programe dhe artikuj të ndryshëm është realizuar me qëllim që t’i shpjegohet publikut procesi i ankimit. Pavarësisht se ky i fundit përqendrohet tek çështjet gjinore, komuniteti rom ka qenë i përfshirë në aktivitetet e realizuar, si: ditë të hapura, konferenca, botime etj.

## Konkluzione dhe Rekomandime

- Mbrojtja nga diskriminimi sipas legjislacionit shqiptar për mosdiskriminimin garantohet lidhur me të gjitha të drejtat themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si dhe ligjet në fuqi. Megjithatë, është e nevojshme që këto ligje të jenë të harmonizuara me Ligjin Shqiptar për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përta i përket shkaqeve për të cilat subjektet mund të mbrohen nga sjelljet diskriminuese si dhe format e diskriminimit.
- Ekziston një gamë e gjerë e ligjeve që parashikojnë parimin e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Megjithatë, rekomandohet ndryshimi i legjislacionit për të bërë të mundur përfitimet nga programet e banesave sociale, regjistrimit të popullsisë apo mbrojtjes sociale.
- Rekomandohet marrja e masave pozitive për nxitjen e trajnimeve, arsimimit dhe punësimit të individëve që i përkasin komunitetit rom.
- Me qëllim shmangien e dëbimeve të dhunshme të komunitetit rom nga trualli ku janë vendosur në mënyrë informale, duhet trajnuar stafi i institucioneve qendrore dhe vendore.
- Realizimi i studimeve dhe vlerësimi i pasojave sociale nga pushteti vendor i programeve të zhvillimit të territorit qoftë për interesa publike, qoftë për zhvillimin e pronës nga pronarët e ligjshëm.

## Literatura

- ✓ Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
- ✓ Ligji nr.10119/2009 “Për planifikimin e Territorit”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr.8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore”.
- ✓ Ligji nr. 8561/1999 “Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë Pronë Private për Interes Publik”.
- ✓ CESCR, 2013, Konkluzionet e Komitetit për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore, 18 Dhjetor 2013.
- ✓ ECHR 5.6.2012, çështja *Yordanova dhe të tjerë kundër Bullgarisë* (nr. 25446 / 06).
- ✓ ECHR 6.4.2000, çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* (nr. 34369 / 97).
- ✓ ECRI General Policy Recommendation No. 7 on National Legislation to Combat Racism and Racial Discrimination, CRI (2003) 8, adopted 13 December 2002.
- ✓ *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore*
- ✓ FRA, Korrik 2010, *Handbook on European Non-Discrimination Law*, European Union Agency for Fundamental Rights, Council of Europe.
- ✓ FRA, March 2010, *The State of Roma and Traveller Housing in the European Union: Steps Towards Equality*, European Union Agency for Fundamental Rights.
- ✓ *General Comment nr. 7*, UN Committee for Economic, Social and Cultural Rights.
- ✓ KMD, 2013, *Annual Report 2013 of the Albanian Commissioner for Protection from Discrimination* ([http://kmd.al/skedaret/1410951832-Annual%20Report\\_2013.pdf](http://kmd.al/skedaret/1410951832-Annual%20Report_2013.pdf)).
- ✓ OSCE / ODIHR, 2013 (30 April 2013), *Overview of Anti-Discrimination Legislation in the Western Balkans*, Varshavia (<http://www.legislationline.org/topics/topic/84>).
- ✓ Progres Raport për Shqipërinë, 2013 ([www.mie.gov.al](http://www.mie.gov.al))

